



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 80 date 15.05.1997

**“KALIMIN KAPITAL TË MJETEVE KRYESORE TË OFIÇINËS
AUTOMJETEVE (OA) TIRANË NË PRONËSI TË NDËRMARRJES
SHËRBIMEVE TRANSPORTIT TIRANË”**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të dt.15.05.1997, pasi shqyrtoi relacionin mbi “Kalimin kapital të mjeteve kryesore të Ofiçinës Automjeteve (OA) Tiranë në pronësi të Ndërmarrjes Shërbimeve Transportit Tiranë”, mbështetur dhe në Vendimin e Këshillit Ministrave Nr.153, dt.03.04.1993 pika.2, gërma.”dh” “Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore” me propozim të Drejtorisë Zhvillimit Ekonomik Bashkisë (Sektori i Transportit e Telekomunikacionit)

VENDOSI

1. Godina e zyrave ish menca dhe rrugët e sheshet lidhëse me to në pronësi të Ofiçinës Automjeteve Tiranë, t’i kalojnë në administrim Ndërmarrjes Shërbimeve Transportit Tiranë.(N.SH.T).
2. Godina një katëshe e OA Tiranë me emërtim repart montimi 2 sipas gent planit bashkangjitur studimit urbanistik, t’i bëhet kalim mjeti kryesor N.Sh.Transporti Tiranë.
3. Sipërfaqja e lirë e OA Tiranë me shtrirje deri në rrugën e re, t’i bëhet kalim mjeti kryesor N.Sh Transportit Tiranë ku si pas studimit është parashikuar shtrirja e saj duke i kthyer OA Tiranë si kompesim nga sipërfaqja ekzistuese një sipërfaqe prej 556 m². Sipërfaqja e territorit që zë Ndërmarrja e Shfrytëzim Transportit Tiranë është 5.612 m².
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Transportit në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë, Ofiçina e Automjeteve Tiranë dhe Ndërmarrja Shërbimeve Transportit Tiranë.

**KRYETARI
ORHAN SAKIQI**

